



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 6 tetor 2017  
Nr. ref.:RK 1133/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI78/16**

Parashtrues

**Driton Syla**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 7/2016, të 18 janarit 2016**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Driton Syla, me banim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 7/2016, i 18 janarit 2016, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 shkurt 2016.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], si dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt), nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) dhe me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesë Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 19 maj 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 29 qershor 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme dhe Drejtorisë Komunale për Arsim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: DKA).
8. Më 13 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy, kryesues të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.
9. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

## **Përmbledhja e fakteve në procedurë administrative**

10. Më 22 korrik 2011, DKA në Gjilan kishte shpallur konkursin për pranimin e një mirëmbajtësi të objektit në Institucionin parashkollor "Ardhmëria I" (në tekstin e mëtejme: IP "Ardhmëria I"), në Gjilan.
11. Më 12 tetor 2011, DKA, me Vendimin 05. nr. 821/2011, shpalli rezultatet në bazë të të cilit, në pozitën mirëmbajtës i objektit në IP "Ardhmëria I" në Gjilan, u pranua kandidati i cili ishte i treti sipas vlerësimit të Komisionit intervistues, ndërsa parashtruesi i kërkesës ishte radhitur si i pari.
12. Më 18 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin Komunal për Shqyrtimin e Ankesave (në tekstin e mëtejme: Komisioni i Ankesave) kundër Vendimit 05. nr. 821/2011 të DKA-së, të 12 tetorit 2011, duke pretenduar se *"Vendimi i DKA-së është në kundërshtim me rezultatin nga procedura e intervistimit, pasi që me vendimin në fjalë është shpallur emri B. M., i cili nuk ka kualifikim adekuat për pozitën e kërkuar si dhe në procedurën e intervistimit ka pasur më pak pikë"*.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar me kërkesë drejtorit të DKA-së, duke kërkuar që *"të ndërpresë veprimet e mëtejshme administrative sipas njoftimit të datës 12.10.2011 deri në marrjen e vendimit përfundimtar sipas ankesës sime në Komisionin për Ankesa dhe nga Gjykata kompetente"*. Parashtruesi i kërkesës pretendon se asnjëherë nuk ka marrë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.
14. Më 25 nëntor 2011, Komisioni i Ankesave, me Vendimin nr. 02-16-46560, aprovoi, si të bazuar ankesën e parashtruesit, si dhe vendosi që të ndryshohet pjesa e II e Vendimit 05. nr. 821/2011 të DKA-së, të 12 tetorit 2012, ashtu që në vend të kandidatit B. M., u vendos që të sistemohej në vend të punës parashtruesi i kërkesës. Në këtë vendim, ndër të tjera, theksohet: *"Obligohet, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në afat prej 15 ditësh ta sistemoj Driton Sylën në pozitën Mirëmbajtës i Objektit në IP "Ardhmëria I" sipas rezultatit nga procedura e intervistimit"*.
15. Nga shkresat e lëndës rezulton se në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë edhe në Inspektoratin e Punës, kundër Vendimit 05. nr. 821/2011 të DKA-së, të 12 tetorit 2011.
16. Më 2 dhjetor 2011, Inspektorati i Punës (Njoftimi nr. 02-999/11), aprovoi, si të bazuar ankesën si dhe urdhëroi DKA-në që në afat prej 8 (tetë) ditësh të pranoj parashtruesin e kërkesës sipas ranglistës së Komisionit intervistues.

## **Përmbledhja e fakteve në procedurë përmbarimore**

17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi propozim në Gjykatën Komunale në Gjilan për përmbarim të Vendimit nr. 02-16-46560, të 25 nëntorit 2011, të Komisionit të Ankesave.
18. Më 16 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin E. 2318/2011, lejoi përmbarimin sipas propozimit të parashtruesit kundër



Komunës së Gjilanit, për kompensim të të ardhurave personale në bazë të Vendimit nr. 02-16-46560, të Komisionit të Ankesave, të 25 nëntorit 2011.

19. Më 23 janar 2012, Komuna e Gjilanit ushtroi kundërshtimin në Gjykatën Komunale në Gjilan ndaj Aktvendimit E. 2318/2011, të 16 dhjetorit 2011, duke pretenduar se *“në propozim për ekzekutim nuk ceket shuma e të hollave që duhet t'i paguaj kreditori”*.
20. Më 5 mars 2012, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin E. 2318/2011, aprovoi si të bazuar kundërshtimin e Komunës së Gjilanit.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, E. 2318/2011, të 5 marsit 2012.
22. Më 24 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktvendimin AC. nr. 129/2012, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, E. nr. 2318/2011, të 5 marsit 2012. Në aktvendim arsyetohet se: *“Aktvendimi i atakuar ka arsye të mjaftueshme, të plota dhe bindëse me të cilat kjo Gjykatë pajtohet në tërësi [...] Ndërsa, sa i përket pretendimit ankimor të kreditorit, se gjykata i zbaton rregullat sipas të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj, ky pretendim ankimor është i pabazuar ngase në pajtim me nenin 24. b të LPP, titull ekzekutiv është edhe vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurën administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me Ligj nuk është para parë diçka tjetër, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me të holla dhe nuk kemi titull ekzekutiv, andaj edhe me të drejt gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kundërshtimin edebitorit”*.
23. Më 7 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Gjilan, me arsyetimin se *“ka marrë dijeni se Gjykata Supreme e Kosovës më 11.12.2012, sipas shkresës Agj. nr. K. 584/2012, e ka ndryshuar qëndrimin parimor të mëhershëm dhe ka konstatuar se vendimi përfundimtar në procedurë administrative është vendim të cilin gjykata duhet ta përmbaroj, andaj ka propozuar që të lejohet përsëritja e procedurës”*.
24. Më 8 tetor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan nxori Njoftimin E. 2318/2011, duke deklaruar se *“në rastin konkret Gjykata Themelore në Gjilan sipas vendimit të Komisionit Komunal për shqyrtimin e ankesave nr. 02-16-46560/2 të datës 25.11.2011 nuk mund të zhvilloj procedurë përmbarimore pasi që në dispozitiv të vendimit nuk është përcaktuar shuma e mjeteve”*.
25. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi parashtrroi kërkesë për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Apelit kundër Njoftimit E. 2318/2011, të Gjykatës Themelore në Gjilan, të 8 tetorit 2013.
26. Më 24 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Cn. nr. 3225/2013, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përsëritje të procedurës. Në arsyetimin e këtij vendimi, Gjykata e Apelit

theksoi se “nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore”.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurë kontestimore**

27. Më 21 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kërkesëpadi kundër DKA-së në Gjilan, duke kërkuar që të zbatohet Vendimi nr. 02-16-46560, i Komisionit të Ankesave, i 25 nëntorit 2011. Parashtruesi kishte kërkuar që të sistemohej në vendin e punës dhe të detyrohet DKA-ja që t'i kompensojë të gjitha pagat nga data e nxjerrjes së Vendimit nr. 02-16-46560, të Komisionit të Ankesave, të 25 nëntorit 2011.
28. Më 5 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C. nr. 884/2011), aprovon kërkesëpadinë e parashtruesit. Më tutje, në aktgjykim shtohet se “*kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar, sepse nga provat e administruara u vërtetua fakti se e paditura nuk e ka zbatuar vendimin e Komisionit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave dhe ky moszbatim ka pasur për pasojë mospasurimin e paditësit Driton Sylja [...] edhe pse e paditura konform nenit 16 të Ligjit për Procedurën Administrative ka pasur për obligim vendimin e sipërpërmendur ta zbatoj [...] Gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësit Driton Sylja t'ia paguaj pagat e papaguara nga dhjetori i viti 2011 deri në tetor të vitit 2012”.*
29. Në një datë të paspecifikuar, DKA-ja kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndaj vendimit të përmendur më sipër të Gjykatës Komunale në Gjilan, me pretendimin se ekzistonin shkelje qenësore e dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i së drejtës materiale.
30. Më 7 tetor 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktvendimi Ac. nr.5020/2012), aprovon ankesën e DKA-së dhe prish Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 884/2011, të 5 nëntorit 2012 dhe lëndën e kthen në rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Gjilan. Në aktgjykim arsyetohet se “*nuk mund të pranohet si të drejtë dhe të ligjshëm konkludimin e gjykatës së shkallës së parë ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par. 1 pika n) të LPK, për të cilat gjykata e shkallës së dytë është detyruar që të kujdeset kryesisht për të cilin shkak aktgjykimi i atakuar doemos është detyruar të priset [...]*”.
31. Më 17 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan, duke vendosur në rigjykim (Aktgjykimi C. nr. 783/2013), pjesërisht aprovon padinë e parashtruesit duke konkluduar si në vijim: “*Pjesërisht aprovohet kërkesëpadija e paditësit Driton Sylja nga Gjilani dhe detyrohet e paditura [...], që të sistemoj paditësin Driton Sylja në vendin e punës mirëmbajtës i objektit në IP “Ardhmëria në Gjilan si dhe t'ia paguaj paditësit pagat e papaguara nga dhjetori i vitit 2011 deri në maj të vitit 2012 [...] Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadiisë së paditësit Driton Sylja, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura [...] që paditësit t'ia paguaj pagat e papaguara për periudhën kohore prej muajit qershor 2012 deri më 30.11.2013”.* Lidhur me refuzimin e pagës për periudhën në fjalë, në arsyetim të aktgjykimit



potencohet se “*paditësi gjatë kësaj periudhe nuk ka pësuar fitim të humbur me fajin e të paditurës ngase ka punuar në firmën Gorenje Niki Tiki [...] pra të ardhura më të mëdha se sa do t'i realizonte sikur të kishte punuar te e paditura*”.

32. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës si dhe Komuna e Gjilanit ushtruan ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
33. Më 17 nëntor 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 925/2014), refuzon si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të Komunës së Gjilanit. Në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera, theksohet se “*Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 në të LPK, siç pretendojnë palët, nuk ka konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe nuk ka konstatim të gabuar të së drejtës materiale*”.
34. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës si dhe DKA në Gjilan, ushtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit Ac. nr. 925/2014, të 17 nëntorit 2015, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
35. Më 18 janar 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 7/2016, vendosi si në vijim: “*I. Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit Driton Syla në pjesën që i referohet pjesës II të aktgjykimit të shkallës së parë lidhur me kompensimin e të ardhurave personale për kohën prej muajit qershor 2012 deri më 30 dhjetor 2013; II. Hidhet si i palejuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 925/1004 datë 17.11.2015, në pjesën që i referohet detyrimit të paditurës që paditësit t’ia paguaj pagat e papaguara nga dhjetori i vitit 2011 deri në maj 2012*”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

36. Gjykata sjell në vëmendje se parashtruesi pretendon se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) si dhe me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.
37. Më konkretisht, parashtruesi pretendon se “[...] *Moszbatimi i vendimit nr. 123/2008 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtrësive dhe zvarritja e paarsyeshme e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, nga autoritetet e KK të Gjilanit përbën shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës [...]. Ky*

*dështim dhe joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë”.*

38. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *“Refuzimi i propozimit përmbartimor nga Gjykata Komunale në Gjilan dhe Gjykata e Qarkut në Gjilan padyshim përbën shkelje të nenit 24 të Kushtetutës sepse në situatë të njëjtë juridike, qytetarët nuk janë trajtuar njëjtë para ligjit dhe nuk kanë siguruar mbrojtje të barabartë ligjore [...] është fakt i pakontestueshëm se dëmi është shkaktuar nga punëdhënësi [...] gjykata ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe me këtë është inkurajuar punëdhënësi që të mos zbatoj vendimet përmbartimore”.*
39. Më tej, parashtruesi pretendon se *“kompensimi i pjesshëm i pagës nga gjykatat, është në kundërshtim me ligjin, Gjykata Themelore në Gjilan ka tejkualuar kërkesëpadinë pasi që është kërkuar kthim në vendin e punës dhe kompensimi i pagës [...] e jo fitimi i humbur [...]”.*
40. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, si në vijim:
- “të konstatoj shkeljen e të drejtave të mija lidhur me kompensimin e pjesshëm, të konstatoj zvarritjen e paarsyeshme të procedurave”.*
41. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 7/2016, të 18 janarit 2016.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

42. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]  
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
44. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*



45. Gjkata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
- (...)
- (d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- (...)
- (d) Parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
46. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor.
47. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë edhe nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.
48. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 7/2016, i 18 janarit 2016, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave në ndërlidhje me të drejtën për një proces të rregullt, e drejta për zgjidhje efektive dhe ndalimi i diskriminimit të KEDNJ-së.
49. Gjykata sjell në vëmendje se në rastin konkret ka disa vendime të nxjerra në procedura të ndryshme, respektivisht në procedurë administrative, përmbartimore dhe kontestimore.
50. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ngre pretendime që kanë të bëjnë me sistemimin ose mossistemimin e tij në vendin e punës, por vetëm çështjen e kompensimit të pagës dhe atë vetëm për një periudhë të caktuar kohore.
51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se thelbi i kërkesës ka të bëjë me vendimet e gjykatave të rregullta dhe atë vetëm për sa i përket kompensimit të një pjese të pagave të porealizuara.
52. Lidhur me këtë, Gjykata vë në pah se vendimi i fundit, të cilin edhe parashtruesi shprehimisht e konteston, është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 7/2016, i 18 janarit 2016, me të cilin aktgjykim u refuzua si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
53. Lidhur me pretendimin e parashtruesit se gjykatat e rregullta, të cilat refuzuan kërkesën e parashtruesit për kompensim të plotë të pagave kanë



shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të lartcekur konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm.

54. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konstatoi se *“në rastin konkret të dy gjykatat drejt i kanë vlerësuar këto rrethana dhe drejt kanë përfunduar se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave personale pasi që paditësi gjatë kësaj kohe nuk ka pasuar dëm në formë të fitimit të humbur (neni 189 LMD), për arsye se ka realizuar të ardhura personale më të larta në vendin tjetër të punës se të ardhurat që ta realizonte në vendin e punës mirëmbajtësit”*.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi lidhur me pretendimet e parashtruesit të cilat tashmë ishin ngritur në gjykatat e shkallës më të ulët.
56. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë përgjigje dhe arsyetime të mjaftueshme për vendimet e tyre lidhur me atë se pse nuk është realizuar në mënyrë të plotë kërkesa e parashtruesit për kompensimin e pagave.
57. Për më tepër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykatat e rregullta kanë bërë kualifikimet dhe interpretimet përkatëse të fakteve dhe ligjeve të zbatueshme në rastin konkret.
58. Gjykata thekson se konstatimet dhe kualifikimet e fakteve si dhe interpretimet ligjore, janë prerogativë e gjykatave të rregullta.
59. Gjykata vë në dukje se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe standardeve përkatëse kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”, në raport me vendimet e gjykatave të rregullta (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu, *mutatis mutandis*, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
60. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, për shkak të tejzgjatjes së procedurës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur argumente dhe fakte të cilat mbështesin këtë pretendim. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës dhe në dritën e rrethanave të rastit, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies në lëvizje të tyre

ishin aktive në gjykimin e çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk kanë shkaktuar tejzgjatje të paarsyeshme të procedurës.

61. Ndërsa, lidhur me pretendimin e parashtruesit se “*në situatë të njëjtë juridike, qytetarët nuk janë trajtuar njëjtë para ligjit dhe nuk kanë siguruar mbrojtje të barabartë ligjore*”, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për trajtim të pabarabartë. Kur pretendohet një shkelje e tillë kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin nr. KI32/16, parashtrues: *Ibrahim Svarça*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 shtatorit 2016).
62. Gjykata thekson që fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të argumentuar një shkelje të pretenduar kushtetuese (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
63. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi.
64. Prandaj, kërkesa, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 6 shtator 2017, njëzëri

### VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Arta Rama-Hajrizi